




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.374/2023
Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, 370 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-139 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, në mbledhjen e 313-të, të mbajtur më 28 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ministrisë së Drejtësisë i propozohen anëtarët dhe anëtarët rezervë të tyre për Komisionin Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, në përbërjen si në vijim:
 1. Manushe Karaqi, gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, anëtare në komision;
 2. Adnan Konushevc, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, anëtar në komision;
 3. Agron Hoxha, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren, anëtar rezervë i komisionit;
 4. Hajrullah Aruqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë dega Skenderaj, anëtar rezervë i komisionit;
- II. Vendimi hyn në fuqi më 28 korrik 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 24 korrik 2023, ka pranuar kërkesë nga Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, Departamenti i Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë për propozimin e dy (2) gjyqtarëve dhe zëvendësit e tyre për emërim në Komisionin Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli në mbështetje të nenit 370 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-139 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Ministrisë së Drejtësisë;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit